

23-06-2022

02--016/01-637



Drejtoria e Shërbimeve Publike,

Nr. /2022 Dt. 21.06.2022

Komuna e Vitisë në bazë të kompetencave dhe nevojave të dala nga kërkesa e DSHP-st për hartimin e planit të veprimit për energji dhe klimë, bazuar në nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit për Eficiencë Nr.06/L-079 bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PER OJQ-te PER HARTIMIN E PLANIT KOMUNAL PER ENERGI DHE KLIM (PVKEK)

Termt e referencës të për hartimin e planit Komunal për energji dhe klimë (PVKEK) në Komunën e Vitisë përmes thirrjeve publik (PVKEK)

Me hartimin e planit të veprimit për energji dhe klimë (PVKEK), Komuna e Vitisë synon anëtarësimin e komunës në Konventën të Kryetarëve (KK). Në fund janarit të vitit 2008, Komisioni Evropian ka iniciuar ndërlidhjen e kryetarëve të qyteteve (krye bashkiave) të qyteteve evropiane për energji dhe klimë në një rrjet të përhershëm me qëllim që të shkëmbejnë përvojat në zbatimin e masave të efikasë për përmirësimin e eficiencës së energjisë dhe klime në mjedis urban.

Iniciativa e Konventës të Kryetarëve (KK) është përgjigje e qytetarëve, udhëheqësve evropian ndaj sfidave të ndryshimit të klimës globale, dhe në të njëjtën kohë, ajo është nisma me ambicioze e Komisionit Evropian, drejtpërdrejt e orientuar drejt përfshirjes aktive dhe pjesëmarrjes të vazhdueshme të administratës Komunale dhe vete qytetar në luftën kundër ngrohjes globale. Me nënshkrimin e Konventës, kryetarët e komunave do të angazhohen për zbatimin e masave të shumta të eficiencës së energjisë dhe klime, të cilat në fund do të qojnë në zvogëlimin e emisioneve të CO₂, në qytete të tyre me më shumë se 20% gjer në vitin 2030, si kërkohej me Propozimin e Politikës Evropiane për Energji dhe Klime nga viti 2017.

Roli i administratës komunale manifestohet nëpërmjet përgjigjeve vijuese të përcaktuara nga Konventat e Kryetarëve (KK):

- 1) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të eficiencës të energjisë dhe klimes në ndërtesat publike, në pronësi ose me qira nga komuna;
- 2) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve të eficiencës së energjisë dhe klimes dhe ruajtjen e mjedisit në sektorin e transportit publik të Komunës;

- 3) Zbatimi i masave, projekteve dhe programeve te eficencës se energjisë dhe klimës ne sektorin e ndriçimit publik te komunës;
- 4) Planifikimi i zhvillimit te qytetit bazuar ne energjinë dhe klimën e qëndrueshme;
- 5) Zbatimi i aktiviteteve te vazhdueshme lidhur me mënyrat e rritjes se eficencës se energjisë dhe zvogëlimin e emisioneve te CO2, me qellim te ngritjes se vetëdijes se qytetareve për nevojën e kursimit te energjisë dhe klimës ne te gjitha fushat e jetës dhe punës;
- 6) Mbështetja e programeve dhe nismave te personave te ndryshëm fizik dhe juridik me qellim te rritjes se përdorimit te burimeve te ripërterishme të energjisë;
- 7) Promovimi i prodhimit vendor te energjisë nga burimet e ripërterishme dhe kogjenerimi.

Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes se ofruesit te shërbimeve:

Kriteret e përgjithshme te thirrjes për hartimin e Planit Komunal te Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Deçanit ka parapare një numër te kushteve te përgjithshme te cilat duhet t'i plotësojë ofruesi i shërbimeve (aplikuesi). Përmes vendosjes së këtyre kushteve të përgjithshme aplikohen standardet minimale formale te cilat kërkohen te plotësohen nga ofruesi i shërbimeve i cili do te hartojë PKVEK-ne te Komunës se Deçanit sipas kriterëve te kërkuara dhe marrëveshjes me GIZ. Kushtet e përgjithshme qe duhet te plotësohen nga ofruesi i shërbimeve (aplikuesi) janë:

1. Të këtë certifikatën e regjistrimit te Certifikata e OJQ-së).
2. Te këtë Certifikatën e OJQ)
3. Te ofroje dëshmi për Pagesat e rregullta te tatimeve; provat qe duhet te dorëzohen janë dëshmitë nga ATK (konform LPP-së kjo dëshmi do të kërkohet vetëm për OE/ofruesin e shërbimeve i cili propozohet për dhënie te kontratës).
4. Ofruesi i shërbimeve duhet që te ofroje dëshmi se ka përvojë ne fushën e eficencës se energjisë, apo burimeve te ripërteritshme te energjisë apo klimën — p.sh. Referenca për ofronin e shërbimeve ne fushën e eficencës te energjisë apo burimeve te ripertërishme të energjisë; hartimin e planeve komunale për eficencë te energjisë/planeve komunale te veprimit për eficencë te energjisë dhe planet komunale te veprimit për energji te qëndrueshme (min. 3 referenca për secilën punë te realizuara te kësaj natyre ne përputhje me legjislacionin e republikës se Kosovës.
5. Ofruesi i shërbimeve duhet te ofroje dëshmi për staf te kualifikuar dhe te siguroje dëshmi për ekspertet/inxhinieret e angazhuar:
 - Te siguroje CV-ne e te paktën 2 inxhinierëve me përvojë te dëshmuar ne fushën e eficencës e energjisë (EE), apo burimeve të ripertërishme te energjisë, planet komunale te veprimit për energji te qëndrueshme dhe monitorimin e planit për eficencë te energjisë apo hartimin e raport progresit te planit për eficencë te energjisë me përvojë minimale 5 vjet, me arsim përkatës: te paktën master ose diplome ekuivalente ne fushat inxhinierike nga këto fusha: i, (elektroteknike, inxhinieri mekanike). Referencat i bashkëngjiten CV-se. (Shënim: përvoja përkatëse do i konsiderohet referenca për zhvillimin e politikave te EE si Plan për EE, Planet për Energji te Qëndrueshme, Monitorimi i Planit për EE apo Hartimi i Planit për EE, politikat lokale/kombëtare për EE ne përputhje me legjislacionin ne Kosove. (Inxhinieri i Makinerisë

dhe i Elktros duhet te jen te certifikuar si Auditor te Energjisë me standardin EN 16247 e lëshuar nga një institucion i Autorizuar sipas Rregullores nr. 05/2020 (MEPTINIS) dhe certifikues për softuerin ISBEM-XK)

- CV e te paktën 4 inxhinierëve, me arsim përkatës me diplome mostër ose ekuivalentë ne fushat inxhinierike (te fushave: arkitekture, ndërtimtari, elektroteknike, inxhinieri mekanike) me 3 vjet, përvojë pune ne efçencën e energjisë, burimet e ripërteritshme te energjisë dhe klimën. Referencat i bashkëngjiten CV-se. (Shënim: përvoja përkatëse do të konsiderohet referenca zhvillimin e politikave te EE si Plan për EE, Planet për Energji te Qëndrueshme, Monitorimi i Planit për EE apo Hartimi i Planit për EE, politikat lokale/kombëtare për EE ne përputhje me legjislacionin ne Kosove), inxhinieret e fushave te cekura duhet te jen te certifikuar si Auditor te Energjisë me standardin EN 16247 e lëshuar nga një institucion i Autorizuar sipas Rregullores nr. 05/2020 (MEPTINIS).
- Një ekonomist, me min. 3 vjet përvojë ne fushën profesionale qe ka te beje me vlerësimin ose analizat e kopontes te politikave te EE dhe BRE, me arsim përkatës: te paktën master ose diplome ekuivalente ne ekonomi. (Shënim: përvoja përkatëse do të konsiderohet referenca si vlerësimin/analizat/investimeve ne komponenten për EE ose BRE.
- Te siguroje qarkullimin bankar për 3 vitet e fundit ne vlerë se paku 30.000.00 euro duke ofruar dëshmi nga banka ose Deklaratat tatimore vjetore te ATK-se.

Dinamika e realizimit te shërbimit: Pas lidhjes se kontratës, ne afat prej 15 ditësh kalendarike, ofruesi i shërbimeve do t'ia dorëzojë Komunës se Vitisë planin e punës për aktivitetet dhe afatin kohor për Draftin e hartimit te PKVEK-se. Ofruesi duhet te ofroje një plan dinamik detal për realizim te këtyre shërbimeve sipas paramases dhe parallogaris.

Shënim: Komunat duhet te përzgjedhin procedurën për shërbimet te energjisë.

Po ashtu Komunat ne kërkesat e FDT-se duhet te harmonizojnë kërkesat e sipër cekura duke bere ndarjen e kërkesave me dëshmi, drafti ka për qëllim vetëm orientimin e kërkesave qe ne si AKK ua kemi propozuar.

Vlerësimi i ofertave/aplikacioneve nga komisioni

Komisioni Vlerësues i ofertueseve për hartimin e Planit Komunat te Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Vitisë varësisht nga kushtet dhe kërkesat e thirrjes lidhur me përmbushjen e kritereve formale do te beje vlerësimin formal te dokumentacionit te dorëzuar nga aplikuesit.

Përmbushja e kritereve formale nënkupton dorëzimin brenda afatit te dokumentacionit, te kerkuara permes thirrjes. Komisioni do te vlerësoj edhe ne rast të vetëm një oferte te përgjegjshme. (Kriteret dhe vlerësimi I ofertave behet konform LPP)

Komisioni do te jetë ne përbërje: 2 anëtar nga Komuna dhe një përfaqësues i GIZ në cilësinë e vëzhguesit/monitoruesit.

(Komunat me rastin e caktimit te Komisionit duhet te kenë parasysh qe ne vlerësim te përfshijnë edhe përfaqësues in e GIZ me vendim te ZKA-se sis përcaktohet me LPP).

Financimi i aktiviteteve për hartimin e PKVEK-se për Komunën e Vitisë

- o Komuna e Vitisë bën thirrje gjithë palëve të interesuara (ofrues të shërbimeve), fushëveprimi i të cilëve është i fokusuar në fushën e energjisë dhe klimës që të aplikojnë për ofrimin e shërbimeve lidhur me hartimin e Planit Komunal të Veprimit për Energji dhe Klime (PKVEK) për Komunën e Vitisë
- o Vlera totale e planifikuar e thirrjes është 30.000,00 €
- o Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është 7 dite kalendarike nga data e publikimit (nga data 21.06.2022) dhe përfundon me 29.06.2022 në ora 13:30.

Vërejtje: Afatet kohore duhet të harmonizohen me LPP.

Kohëzgjatja e projektit dhe e drejta e aplikimit ne thirrjen publike për hartimin e PKVEK-se për Komunën e Vitisë.

- o Periudha e zbatimit te kontratës është 6 muaj (shënim: Kontrata duhet të përfundojë ne Nëntor 2022)
- o Te drejte aplikimi kane ofrues te shërbimeve qe plotësojnë kriteret e lartpërmendura dhe qe dëshmojnë se fushëveprimi i tyre është i fokusuar ne fushën e energjisë dhe klimës.
- o Dokumentet e kompletuara duhet te dërgohen ne formën fizike ne zyre të projekteve.
- o Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve /ofertave, vlerësimit të aplikacioneve/ofertave, kontraktimi, koha dhe mënyra e parashtrimit te ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit te thirrjes janë konform ligjit.

